# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6781
E martë, 13 dhjetor 2022
çmimi 0.40


## Gexha: Ngritja e sigurimeve shëndetësore mbetet sfidë

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


SITUATA E FUNDIT NË VERI, I DËRGUARI I POSAÇËM I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR, VJEN NË PRISHTINË

FAQE 4

# ESCOBARI NË PRISHTINË, THEKSOHET NEVOJA URGJENTE E HEQJES SË BARRIKADAVE NË VERI





I dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka takuar të hënën në Prishtinë, në takime të veçanta, presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti. Temë diskutimi ka qenë situata në veri, ku u theksua nevoja urgjente e heqjes së barrikadave të vendosura nga strukturat ilegale të organizuara nga bandat kriminale dhe të dirigjuara nga Vuçiqi. Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë thekuar se Kosova vazhdon të jetë palë konstruktive në procesin e dialogut



## KONJUFCA: S'DO TË LEJOJMË QË VUÇIQI PËRMES BANDAVE KRIMINALE TË KOMANDOJË NË KOSOVË

FAQE 5

## BORRELLI BËN THIRRJE PËR ULJEN E TENSIONEVE



## OPINION

### EULEX-I NUK ËSHTË QEVERI, AS BORRELLI KRYEMINISTËR. MERRNI PËRGJEGJËSI!

F. 6-7

Reagim i KMDLNj-së

## AKTUALE



### ARTISTËT E MËDHENJ MBËSHTETIN KËRKESËN QË LULËKUQJA TË BËHET SIMBOL I GJENOCIDIT NË KOSOVË

F. 7

### PËRBALLË RRITJES SË RASTEVE ME COVID, KINA MOBILIZON SISTEMIN SHËNDETËSOR

F. 2

## EKONOMI




### DHOMA E TREGTISË: BOJKOTONI PRODUKTET E SERBISË!

F. 8

### KOSOVA, SHQIPËRIA DHE MAQEDONIA E VERIUT, MARRËVESHJE PËR KRIJIMIN E PARKUT NDËRKUFITAR

F. 8

## SPORT



### EDHE NJË SUKSES I GJIMNASTEVE TË KOSOVËS

F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Irani kryen ekzekutimin e dytë për protestat anti-qeveritare

TEHRAN, 12 DHJETOR - Irani ka varur një burrë në publik më 12 dhjetor. I ekzekutuari ishte dënuar për vrasjen e dy anëtarëve të forcave të sigurisë. Ky është ekzekutimi i dytë që lidhet me protestat anti-qeveritare, i kryer në më pak se një javë.
Ekzekutimi i Majidreza Rahnavard, që u raportua nga agjencia "Mizan", vjen pasi gjykata revolucionare në Mashahd e dënoi atë për "luftë kundër Zotit", një akuzë e dënueshme me vdekje. Ai pretendohej se kishte vrarë me thikë dy anëtarë të milicisë famëkeqe paramilitare Basij gjatë protestave në nëntor.
Gjykatat revolucionare të Iranit janë kritikuar nga ndërkombëtarët për shkak se nuk u lejojnë të pandehurve t'i zgjedhin avokatët apo të kenë qasje në provat që gjykatat kanë kundër tyre.
Mashhad, një qytet i shenjtë shiit, gjendet 740 kilometra në lindje të kryeqytetit iranian, Teheran. Aktivistët kanë thënë se në këtë qytet ka pasur greva, dyqanet janë mbyllur dhe ka pasur protesta të nxitura pas vdekjes së 22-vjeçares Mahsa Amini.
Më 8 dhjetor Irani kreu ekzekutimin e parë, duke varur protestuesin Moshen Shekari, pasi Gjykata Supreme e Iranit hodhi poshtë apelin e tij.
Shekari ishte akuzuar për veprën "luftë", përkatësisht dyshohej se kishte plagosur një zyrtar të sigurisë.
Aktivistët kanë paralajmëruar se të paktën dhjetëra persona veçse janë dënuar me dënime me vdekje në seanca të mbyllura gjyqësore.
Mijëra iranianë kanë protestuar në mbarë vendin që kur Amini vdiq në shtator teksa ishte në paraburgim. Ajo po akuzohej nga autoritetet se kishte shkelur rregullat e veshjes së hixhabit, apo shamisë së kokës.
Qeveria iraniane nisi shtypjen brutale, dhe shpesh vdekjeprurëse, të protestave. Ndërkaq, ligjvënësit kanë kërkuar dënime të ashpra për demonstruesit.
Protestat aktuale në Iran janë shndërruar në sfidën më të madhe për udhëheqjen e vendit




që nga Revolucioni Islamik i vitit 1979.
Agjencia e lajmeve HRANA ka thënë se deri më 29 nëntor të paktën 459 protestues janë vrarë gjatë trazirave, përfshirë edhe 64 persona nën moshën madhore.
Iran Human Rights, organizatë me bazë në Oslo, ka thënë se numri i ekzekutimeve në Iran gjatë këtij viti ka tejkaluar shifrën prej 500 qind.
Grupet e të drejtave të njeriut dhe qeveritë perëndimore kanë paralajmëruar Teheranin kundër shqiptimit të dënimeve me vdekje për protestuesit pas proceseve të përshpejtuara gjyqësore, që disa i kanë cilësuar si drejtësi "të rreme".

# Vdesin tre fëmijë pasi ranë në një liqe në Britani



LONDËR, 12 DHJETOR - Tre fëmijë kanë vdekur dhe një tjetër është dërguar në spital në gjendje kritike, pasi kanë ranë në një liqe të ngrirë, Babbs Mill Park, në Solihull të Britanisë së Madhe, të dielën.
Djemtë e moshës 8, 10 dhe 11-vjeçare kanë vdekur, ndërsa kërkimet në liqe po vazhdojnë "për të përcaktuar saktësisht se çfarë ka ndodhur dhe nëse dikush tjetër ka rënë në ujë".
Mendohet se ata kishin luajtur në akull në Babbs Mill Park, tha policia.
Ata u dërguan me urgjencë në spital pasi u nxorën nga uji, por autoritetet britanike thanë se ishte e pamundur që të shpëtoheshin, duke shtuar se e kuptojnë se sa "shqetësuese është kjo për familjet dhe komunitetin e gjerë".
Temperaturat mendohet se kanë rënë -1 gradë celsius në momentin e incidentit, duke rënë në -3 gradë celsius gjatë natës.
"Mund të duket piktoreske, por mund të jetë vdekjeprurëse", tha një punëtor shpëtimi. "Ju lutemi ndihmoni që kjo të mos ndodhë përsëri". Kryeministri britanik Rishi Sunak u ka shprehur ngushëllime familjarëve.

## Përballë rritjes së rasteve me Covid, Kina mobilizon sistemin shëndetësor

PEKIN, 12 DHJETOR - Përballë një rritje të rasteve me Covid-19, Kina po krijon më shumë qendra të kujdesit intensiv e po përpiqet ta forcojë shërbimin spitalor. Këto zhvillime vijnë ndërsa Pekini po heq testimet e detyrueshme e kufizimet e tjera që kishin bllokuar me miliona njerëz në shtëpi, kishin dëmtuar ekonominë, apo që u bënë shkak për protestat më të mëdha në vend në një dekadë.
Zyrtarisht qeveria e presidentit Xi Jinping është ende e përkushtuar për ta ndaluar transmetimin e virusit, por lëvizjet e fundit sugjerojnë se Partia Komuniste në pushtet do të tolerojë më shumë raste pa karantinë, ndalim të udhëtimeve apo mbyllje të bizneseve ndërsa po shkon drejt dhënies fund të strategjisë së saj të ashtuquajtur zero tolerancë ndaj Covidit. Zyrtarët bënë thirrje për mobilizim të plotë të sistemit shëndetësor, përfshirë shtimin e personelit mjekësor dhe rritje të furnizimeve me ilaçe. Por disa restorante dhe biznese vazhdojnë të jenë të mbyllura sepse shumë prej punonjësve të tyre janë të sëmurë.
Nuk është e qartë se sa janë rritur numrat e infeksioneve që nga java e kaluar kur Pekini i dha fund testimit të detyrueshëm për Covid. Por, sipas disa njoftimeve, ka shpërthime të virusit në biznese e shkolla në të gjithë vendin.
Ekspertët paralajmërojnë se ekzistojnë mundësitë që partia në pushtet ta ndryshojë kursin dhe t'i rivendosë kufizimet në rast të një mbingarkese në spitale.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

## Mbyllen shkollat serbe në veri të Kosovës

Mitrovicë, 12 dhjetor - Shkollat fillore dhe të mesme në komunat në veri të Kosovës nuk do të punojnë deri në njoftimin e radhës, për shkak të situatës aktuale të sigurisë, konfirmoi drejtori i shkollës fillore "Sveti Sava" në Mitrovicën e Veriut, Miodrag Jovanoviq, për Radion Evropa e Lirë.
Ai nuk dha detaje se deri kur nuk do të shkojnë nxënësit në shkollë, por vetëm tha se një vendim i tillë është marrë të dielën mbrëma.
"Me shumë gjasa" është marrë nga institucionet kompetente, tha ai.
Shkollat në mjediset serbe në veri të Kosovës funksionojnë nën sistemin e Serbisë.



# Ministrja gjermane: Retorika e Serbisë rrit tensionet në Kosovë

**Prishtinë, 12 dhjetor** - Ministrja e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock, ka thënë se paralajmërimet e Serbisë për shqyrtimin e dërgimit të forcave të saj në Kosovë janë "krejtësisht të papranueshme".
Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, paralajmëroi të shtunën se autoritetet serbe do të bëjnë kërkesë te misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, që në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ta sigurojë dislokimin e pjesëtarëve të ushtrisë dhe policisë serbe në territorin e Kosovës.
Rreth kësaj kërkese nuk pati reagim nga KFOR-i.
Paralajmërimi i Vuçiqit erdhi pasi Policia e Kosovës shtoi praninë e saj në pjesën veriore të vendit, të banuar me shumicë serbe.
Situata atje ka javë që është tensionuar, fillimisht për shkak të planit të Qeverisë së Kosovës për t'i riregjistruar makinat me targa të paligjshme serbe, pastaj për shkak të zgjedhjeve të planifikuara në atë pjesë, që kundërshtoheshin nga serbët lokalë.
Si pasojë e tensioneve në rritje, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i shtyu zgjedhjet e parapara më 18 dhjetor për në prill të vitit të ardhshëm.
Në një postim në "Twitter", Baerbock tha se Kosova i ka ulur tensionet me shtyrjen e zgjedhjeve, por retorika e fundit e Serbisë, sipas saj, bën të kundërtën.
Ministrja gjermane tha se janë "të papranueshme" edhe sulmet mbi misionin e BE-së në Kosovë, EULEX.
Një patrullë e këtij misioni u sulmua mbrëmjen e së shtunës me shok bombë nga, siç u tha, persona të armatosur në pjesën veriore të Kosovës.
Ditët e fundit atje ka pasur disa incidente me armë zjarri, për të cilat autoritetet e Kosovës kanë fajësuar "bandat kriminale", të udhëhequra nga Beogradi.



# Gexha: Ngritja e sigurimeve shëndetësore mbetet sfidë



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 12 dhjetor** - Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Mbulimit Universal me Shërbime Shëndetësore, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë - PRAK ka mbajtur një tryezë me temën "Pse pas tetë vjetësh nga miratimi i ligjit nuk kemi sigurime shëndetësore?!".
Ushtruesja e detyrës e ministrit të Shëndetësisë, Dafina Gexha, ka theksuar se ngritja e sigurimeve shëndetësore është sfidë për sektorin e shëndetësisë. Ajo ka thënë se aktualisht po punojnë në SISh, por edhe se reformat e tyre përfshijnë edhe aspektin e sigurimeve shëndetësore.
Implementimi i skemës të sigurimeve shëndetësore, Gexha, tha se është prioritet i MSh-së.
Kryetarja e Komisionit për Shëndetësi, Fatmire Kollçaku, ka theksuar se ligj aktual ka nevojë për plotësim-ndryshime, derisa theksoi se i gjithë fokusi i Fondit për Siguri Shëndetësore është kthyer vetëm te trajtimi jashtë vendit.
Kollçaku ka thënë se aktualisht janë në fazën e përgatitjes së pakos bazike për sigurime shëndetësore.
E ushtruesi i detyrës i drejtorit të Fondit për Sigurime Shëndetësore, Bujar Kaçuri, ka thënë se 80 për qind i aktivitetit të Fondit fokusohet në programin për trajtim jashtë vendit, në program me të cilin, sipas tij, janë evidentuar shumë probleme, por edhe borxhe mbi 30 milionë euro.
Ai ka thënë se deri më tani nuk është bërë asnjë ndryshim në udhëzimin administrativ sa i takon këtij programi.
Kaçuri u shpreh se përkundër sfidave që kanë me një plan konkret dhe harmonizim të të gjithë aktorëve, shpresojnë që në një të ardhme jo të largët ta fillojnë implementimin e skemës për sigurime shëndetësore.

## Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, marrëveshje për krijimin e parkut ndërkufitar

**Tiranë, 12 dhjetor** - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, së bashku me homologën Mirela Kumbaro nga Shqipëria dhe Naser Nuredinin nga Maqedonia e Veriut, kanë nënshkruar në Tiranë një memorandum për krijimin e një zone të mbrojtur të përbashkët mes tri shteteve me një sipërfaqe që i kalon 240 mijë hektarë. "Në të përfshihen Korab-Koritniku, Sharri, Mavrova dhe Mali i Sharrit, krejt kjo për t'i dhënë më shumë jetë parkut më të madh ndërkufitar në Evropë me një sipërfaqe që i kalon 240 mijë hektarë. Të bindur se një marrëveshje ndërkombëtare është thelbësore për ruajtjen e vlerave të jashtëzakonshme mjedisore, ekonomike, shkencore, kulturore dhe estetike për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm, me qëllimin kryesor që të zhvillojmë, promovojmë, menaxhojmë e ruajmë zonat tona të mbrojtura ndërkufitare", ka shkruar Aliu në "Facebook".





SITUATA E FUNDIT NË VERI, I DËRGUARI I POSAÇËM I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR, VJEN NË PRISHTINË

# Escobari në Prishtinë, theksohet nevoja urgjente e heqjes së barrikadave në veri

I dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka takuar të hënën në Prishtinë, në takime të veçanta, presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti. Temë diskutimi ka qenë situata në veri, ku u theksua nevoja urgjente e heqjes së barrikadave të vendosura nga strukturat ilegale të organizuara nga bandat kriminale dhe të dirigjuara nga Vuçiqi. Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë thekuar se Kosova vazhdon të jetë palë konstruktive në procesin e dialogut

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 12 DHJETOR - I dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka takuar të hënën në Prishtinë, në takime të veçanta, presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti.

Escobar me Osmanin dhe Kurtin ka diskutuar për zhvillimet e fundit në veri.

Presidenca e Kosovës ka njoftuar përmes një komunikate për medie për takimin Osmani-Escobar, duke bërë me dije se u theksua nevoja urgjente e heqjes së barrikadave në veri të vendit, të vendosura nga strukturat ilegale serbe. "Presidentja Osmani shprehi falënderimin për mesazhin e qartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të shprehur dje, lidhur me zhvillimet e fundit në veri të vendit dhe kërkesën për heqjen e menjëhershme të barrikadave e ndalimin e kërcënimeve dhe frikësimit të qytetarëve lokal, si dhe sulmeve ndaj Policisë së Kosovës, zyrtarëve të komisionit zgjedhor dhe misionit të EULEX në Kosovë. Në takim është diskutuar për zhvillimet e fundit në vend dhe në rajon. Presidentja Osmani ka theksuar nevojën urgjente të heqjes së barrikadave në veri të vendit të vendosura nga strukturat ilegale të organizuara nga bandat kriminale dhe të dirigjuara nga Vuçiqi", është bërë me dije në komunikatën e Presidencës.

Sipas komunikatës, Osmani ka potencuar se sulmet ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës dhe atyre ndërkombëtare janë krime për të cilat autorët e këtyre sulmeve duhet të përballen urgjentisht me drejtësinë. "Në takim me emisarin Escobar, presidentja Osmani ka potencuar se Kosova vazhdon të jetë palë konstruktive në procesin e dialogut, dhe se veprimet e Serbisë janë tentim për të minuar dialogun për njohje të ndërsjellë. Në takim u diskutua se si të avancohen edhe më tej raportet mes Republikës së Kosovës dhe SHBA-ve, dhe në veçanti kërkesën e presidentes Osmani të bërë në qershor 2022 për fillimin e dialogut strategjik në mes dy shteteve, si dhe integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike", është bërë me dije në komunikatën e Presidencës.

Escobari nuk ka folur për mediat rreth vizitës së tij në Kosovë.

Zyrtari i lartë amerikan është takuar edhe me kryeministrin Albin Kurti. "U diskutua për situatën aktuale dhe zhvillimet e fundit, veçanërisht në pjesën veriore të Republikë së Kosovës. U theksua se barrikadat në rrugë duhet të largohen menjëherë. Në takim gjithashtu u diskutua për raportet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, procesin e dialogut dhe për rrugën përpara drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Të martën Escobar pritet të takohet edhe përfaqësues të partive politike opozitare.

Një ditë më herët, Shtetet e Bashkuara shprehën shqetësim të thellë për situatën aktuale në veri të Kosovës dhe bënë thirrje për çmontimin e menjëhershëm të barrikadave të ngritura në veri të Kosovës nga serbët lokalë.

Bashkë me Esobarin në Kosovë ishte paraparë që të vinte edhe këshilltari i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, i cili anuloi vizitën në disa shtete të Ballkanit dhe në Bruksel, pasi doli pozitiv me sëmundjen Covid-19.

Vizita vjen në kohën kur situata në veri të Kosovës, zonë e banuar me shumicë serbe - është e tensionuar.

Barrikadat e ngritura më më 10 dhjetor, bllokuan rrugët që çojnë drejt pikave kufitare me Serbinë, Jarinjë dhe Bërnjak.

Ky veprim i serbëve lokalë erdhi pasi Policia e Kosovës arrestoi ish-zyrtarin serb të këtij institucioni, Dejan Pantiq, nën dyshimet se ka organizuar "sulm terrorist" në zyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri të Kosovës. Ndaj u caktua një muaj paraburgim.

Të dielën, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se pret që KFOR-i t'i largojë barrikadat nga veriu.



# Konjufca: S’do të lejojmë që Vuçiqi përmes bandave kriminale të komandojë në Kosovë

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, duke folur për situatën e fundit në veri, ka theksuar se veprimet e Serbisë janë të papranueshme, ato kanë për qëllim destabilizimin dhe ndarjen de-fakto të shtetit të Kosovës. “Ne si popull qëndrojmë shumë të bashkuar që t’i luftojmë këto veprime, të cilat kanë si prapavijë gjeopolitike ndikimin rus dhe fuqishëm do të ecim në shtetin demokratik të Kosovës për sundim të ligjit dhe për demokraci në tërë territorin e Republikës së Kosovës”, është shprehur Konjufca, duke shtuar se nuk do të lejojnë që Vuçiqi përmes bandave kriminale të komandojë në Kosovë




EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, pas takimit me homologun e tij në Shkup, Talat Xhaferi, ka theksuar se rajoni nuk është imun nga ndikimet e Rusisë dhe kjo vërehet në veprimet e Serbisë gjatë ditëve të fundit në Kosovë. “Veprimet e Serbisë janë të papranueshme, ato kanë për qëllim destabilizimin dhe ndarjen de-fakto të shtetit të Kosovës. Ne si popull qëndrojmë shumë të bashkuar që t’i luftojmë këto veprime, të cilat kanë si prapavijë gjeopolitike ndikimin rus dhe fuqishëm do të ecim në shtetin demokratik të Kosovës për sundim të ligjit dhe për demokraci në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Kosova është e përcaktuar për zgjidhjen e problemeve përmes dialogut”, ka theksuar në Shkup, Konjufca, duke komentuar zhvillimet në Kosovë.

Situata në veri të Kosovës, zonë e banuar me shumicë serbe, është e tensionuar, pasi disa serbë lokalë atje, qysh më 10 dhjetor, ngritën barrikada dhe bllokuan rrugët që çojnë drejt pikave kufitare me Serbinë, Jarinjë dhe Bërnjak. Këto veprime i ndërmorën pasi Policia e Kosovës arrestoi ish-pjesëtarin e këtij institucioni, Dejan Pantiq, nën dyshimet për përfshirje në sulme kundër zyrtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri të Kosovës dhe atyre policorë derisa KQZ-ja po bënte përgatitje për zgjedhjet lokale në komunat veriore: Leposaviq, Zveçan, Mitrovicë e Veriut dhe Zubin Potok.

Gjatë vizitës në Shkup, Konjufca ka thënë se gjatë këtij muaji Kosova ka ndërmarrë dy veprime, të cilat kanë qenë plotësisht të koordinuara me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Bashkimin Evropian: arritjen e marrëveshjes në Bruksel për çështjen e targave dhe shtyrjen e zgjedhjeve në veri të Kosovës. “Serbia, në anën tjetër, u përgjigj me mbështetjen e eksponentëve, të cilët janë në krye të krimit të organizuar në atë pjesë të Kosovës e të cilët ndërmarrin veprime të dhunshme dhe të armatosura kundër Policisë së Kosovës dhe i mbyllin rrugët e karakterit ndërkombëtar përmes vendosjes së barrikadave të paligjshme”, ka thënë Konjufca, duke rikujtuar që “këta eksponentë janë në listën e zezë të ShBA-së dhe të Britanisë së Madhe”. “Nuk do të lejojmë që brenda territorit të Kosovës [Aleksandar] Vuçiqi të komandojë përmes këtyre bandave”, ka deklaruar Konjufca.

Në listën e zezë amerikane është nënkryetari i Listës Serbe, Milan Radoiçiq, për shkak të dyshimit për përfshirje në krimin ndërkombëtar. Ndërkaq, Britania e ka futur në listën e sanksioneve sa i përket korrupsionit.

Vetë Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, ka njoftuar se Radoiçiqi është “bartës i rezistencës” në veri.

I pyetur për veprimet e Prishtinës zyrtare nëse eskalon situata në veri, Konjufca ka thënë se “qëllimi i Serbisë është eskalimi i situatës, mirëpo Kosova është për të kundërtën, pra që të ulen tensionet”. “Tash është radha e Serbisë që të distancohet prej këtyre grupeve, të cilat bëjnë veprime të paligjshme dhe kriminale në pjesën e veriut të Kosovës. Bashkësia ndërkombëtare duhet të jetë më e zëshme në dënimin e këtyre grupeve, të cilat janë drejtpërdrejt nga ana e Beogradit dhe Beogradi këtë gjë nuk po e fsheh. Pra, zyrtarë, edhe komunalë edhe policorë, të cilët dhanë dorëheqje nga të gjitha institucionet e Kosovës, po flas për veriun e Kosovës, u paraqitën në konferencë të përbashkët shtypi me presidentin e Serbisë - kjo për të treguar se përpjekja e tyre është e organizuar dhe e orkestruar. Pra, nëse doni të thoni se kush është përgjegjëse për këtë që ndodh në atë pjesë të veriut të Kosovës, përgjigjet i keni të qarta, sepse ata këtë as që po e fshehin”, është shprehur Konjufca.

Ai është shprehur se “përgjegjësi e Kosovës është që ne ta arrijmë sigurinë, implementimin në pjesën e Veriut të Kosovës, po të njëjtën kohë të mos bëjmë kompromis me sundimin e ligjit”.

Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, ka theksuar se të dyja palët, Kosova dhe Serbia, duhet të veprojnë në mënyrë racionale lidhur me situatën e krijuar në veri të Kosovës. “Përskaj kompetencave të institucioneve të Republikës së Kosovës, garantues i sovranitetit dhe integritetit të Republikës së Kosovës përmes Kombeve të Bashkuara me mandat është përcaktuar NATO-ja, si forcë e cila duhet ta sigurojë rendin, qetësinë dhe lirinë e lëvizjes, si dhe funksionimin e shtetit të Republikës së Kosovës. Edhe ne [Maqedonia e Veriut], si anëtare e plotfuqishme e NATO-s, jemi pjesë e kontingjentit të NATO-s në Republikën e Kosovës dhe për këtë arsye obligimet që burojnë nga mandati i NATO-s duhet të sigurojnë atë që e kanë si mandat nga Rezoluta e OKB-së”, ka theksuar Xhaferi.

# Borrelli bën thirrje për uljen e tensioneve



PRISHTINË, 12 DHJETOR - Përfaqësuesi për Politikë të Jashtme dhe Siguri i bllokut evropian, Josep Borrell, ka kërkuar nga Kosova dhe Serbia t’i ulin tensionet, duke shtuar se dhuna në veri të Kosovës është “e papranueshme”.

Shefi i diplomacisë së Bashkimit Evropian i bëri këto komente para një takimi të ministrave të Jashtëm të bllokut që po mbahet në Bruksel, teksa u kërkoi palëve që t’i kthehen dialogut. “Ata duhet t’i kthehen dialogut. Ata duhet ta tejkalojnë këtë tendencë të konfliktit në rrugë, krijimin e bllokadave. Kjo nuk është mënyra se si kërkohet marrëveshja. Kjo nuk është mënyra se si zhvillohen bisedimet. Kjo nuk është mënyra se si kërkohet zgjidhja, se si kërkohet normalizimi i raporteve përmes procesit në të cilin ata janë angazhuar”, tha Borrell.

Ditët e fundit tensionet në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe janë rritur, me serbët që kanë ngritur barrikada dhe me Policinë e Kosovës që ka shtuar praninë e saj në këtë pjesë të shtetit.

Policia e Kosovës ka njoftuar se ka qenë cak i disa sulmeve, teksa edhe misioni i BE-së në Kosovë për sundim të ligjit, EULEX, ka raportuar se është sulmuar me shok bombë në fshatin Rudarë të Zveçanit.

Serbët nisën ngritjen e barrikadave në veri të Kosovës më 10 dhjetor, pas arrestimit të ish-pjesëtarit të Policisë së Kosovës, Dejan Pantiq. Kosova argumenton se ai qëndron pas sulmeve ndaj zyrave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri.

Por, Borrelli tha se bllokimi i rrugëve, si kundërpërgjigje ndaj arrestimit të ish-policit serb, është i papranueshëm. “Unë e di se të dyja palët janë të gatshme që t’i ulin tensionet dhe fuqishëm i ftoj të dyja palët që ta bëjnë këtë. Por, në këtë rast, unë kam qenë në kontakt me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, ndërsa i dërguari i posaçëm [i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav] Lajçak, ka qenë në kontakt me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Kjo prishje e rendit publik dhe kjo dhunë është e papranueshme”, tha ai.

Për shkak të rritjes së tensioneve, Policia e Kosovës ka mbyllur përkohësisht dy pikëkalimet kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak, që lidhin Kosovën dhe Serbinë.

Po ashtu, autoritetet kanë shtyrë për në prill mbajtjen e zgjedhjeve lokale në veri, që ishin paraparë të mbaheshin më 18 dhjetor.

Mitrovica e Veriut, Zubin Potoku, Zveçani dhe Leposaviqi janë pa kryetarë që nga nëntori, pasi ata - së bashku me policët serbë dhe punëtorët e sistemit të drejtësisë në veri - dhanë dorëheqje për shkak të një vendimi të Qeverisë së Kosovës për riregjistrimin e makinave me targa RKS.

Reagim i KMDLNj-së

# EULEX-i nuk është qeveri, as Borrelli kryeministër. Merrni përgjegjësi!

Situata në veri të Kosovës ka përshkallëzuar sipas një plani veprimi të Serbisë dhe ndërkombëtarëve ndërkaq që institucionet e Kosovë patën një reagim të qullët, shumë zhurmë dhe mungesë guximi për të vepruar. Presidentja e Kosovës i shpalli zgjedhjet ndonëse nuk kishte fare kushte për t'i mbajtur ato. Me rirebelimin e serbëve që tani është shndërruar në model shantazhimi në veri dhe kërcënimin se do të përhapet edhe në pjesët e tjera të Kosovës, me kërkesën e vendeve të QUINT-it, me paralajmërimin e ardhjes së dvojkës amerikane, Chollet dhe Escobar, u krijuan të gjitha kushtet të ngrihet flamuri i bardhë, flamuri i dorëzimit para bandave kriminale serbe të veriut, të përkrahura nga Serbia dhe BE-ja. Presidentja Osmani ftoi për konsultime subjektet politike, sa për të krijuar një alibi dalëse nga kjo situatë, shkaku se ka mungesë guximi për të vepruar dhe, pas kësaj, duke manipuluar me këtë takim konsultativ, i anuloi zgjedhjet që vet i ka shpallur, pa pajtimin e opozitës dhe në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Kosovës. Opozita e Kosovës duhet ta dërgojë këtë rast në Gjykatën Kushtetuese sepse presidentja Osmani në mënyrë flagrante e ka shkelur Kushtetutën. Kryeministri Kurti kërkon nga KFOR të sigurojë lirinë e lëvizjes sikur edhe nga EULEX që t'i largojë barrikadat thuaja se këta i kanë fituar 51 për qind të votave dhe se kanë ndonjë detyrim ndaj ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës. Ministri i baushtellës, ish-përkthyesi i KFOR-it norvegjez dhe rreshter i ushtrisë norvegjeze, tash si ministër i Mbrojtjes së Kosovës, nga një distancë e sigurisë personale dhe familjare, lëshon kushtrim për luftë, i papërgjegjshëm siç është ndonëse askush nuk e pyet për asgjë dhe nuk vendosë për asgjë. Kryeministri i Kosovës duhet ta sqarojë opinionin pse nuk po e dërgon në Veri Njësinë Speciale të Policisë së Kosovës të cilën KFOR nuk e ka lejuar të shkojë në Veri të Kosovës duke e ndaluar në kufi prandaj ka dërguar policë për ruajtje të rendit dhe sigurisë, pa pajisje të nevojshme për menaxhim të përshkallëzimit të dhunës të bandave dhe njësive paramilitare në këtë pjesë të okupuar të Kosovës. Në këtë mënyrë i ka shndërruar në pëllumba prej argjilit, cak i lehtë për t'u goditur nga sulmues të thjeshtë e lërë më profesionistë që operojnë në veri. Moslejimi i dërgimit të Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës, a mos është zotim i palës kosovare pas nënshkrimit të Marrëveshjes për targa ilegale kohëve të fundit?! Opozita kosovare ka qenë jopenguese, edhe më shumë se që është kërkuar nga ajo duke mos e penguar qeverinë për asgjë. Qeveria duhet të marrë përgjegjësinë e 51 për qind të votave të fituara sepse këtë përgjegjësi edhe e ka kërkuar. Është e pamoralshme dhe e padinjitetshme që mungesën e guximit për t'u përballur me problemet reale për të cilën e kanë përkrahjen e tërë shoqërisë, pa dallime partiake dhe të tjera ta adresojnë vetëm te e kaluara duke sulmuar persona që janë të burgosur e që nuk kanë ndikim dhe nuk paraqesin asnjë pengesë për marrje të vendimeve që kanë mbështetje ligjore dhe kushtetuese. Pikërisht e kaluara ua ka siguruar 51 për qind të votave por nuk iu siguron guximin për marrje të përgjegjësive sepse nuk duan të përballen me këtë përgjegjësi. Është e pamoralshme të kërkoni nga KFOR dhe EULEX të kryejnë përgjegjësitë institucionale, nga një distancë e sigurisë personale dhe familjare apo duke ngrënë flija në odat e fshatrave shqiptare në veri të Kosovës, të rrethuar dhe siguruar nga Policia e Kosovës. Duhet ta kenë të qartë se heqja e barrikadave nga KFOR -i dhe ndërkombëtarët pa asnjë dyshim do të rezultojë me lëshime të reja nga institucionet e Kosovës. Banorët shqiptarë në Veri të Kosovës janë të pambrojtur dhe rrezikuar nga bandat paramilitare serbe dhe nuk është aspak e pamundur të përsëritet shkurti i vitit 2000 kur në prani dhe përkrahje të xhandarmerisë franceze nga forcat paramilitare serbe që edhe sot janë aktive në Veri të Kosovës, në Mitrovicë ishin ekzekutuar 11 shqiptarë dhe ishin shpërngulur dhunshëm mbi 13 mijë shqiptarë dhe joserbë. Opozita e Kosovës duhet të jetë opozitë konstruktive dhe ta përkrahë pozitën në çdo situatë që është në interes të qytetarëve dhe shtetit të Kosovës e jo që t'i nënshtrohet presionit dhe shantazhit ndërkombëtar duke u shndërruar në patericë për t'i siguruar qeverisë shtegdalje nga situatat që vet i ka krijuar. Nëse opozita nuk e dërgon presidenten në Gjykatën Kushtetuese për anulim kundërkushtetues të zgjedhjeve, atëherë edhe vet do të bëhet pjesë e përgjegjësisë. Opozita duhet të dërgojë në Gjykatën Kushtetuese të gjitha ligjet që janë votuar në Kuvend me arrogancën e numrave e që janë në kundërshtim të plotë me Kushtetutën, me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Opozita duhet të kundërshtojë folklorizmin tallava legjislativ që po bëhet për qëllime të manipulimit politik. Opozita duhet të kërkojë sqarime dhe të pengojë degradimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës ku janë bërë spastrime staliniane dhe ku askush nuk i nënshtrohet përgjegjësisë për vdekjen dhe vetëvrasjen e personave të privuar nga liria. Opozita duhet të kërkojë hetim parlamentar për zhdukjen e mostrave nga Instituti i Mjekësisë Ligjore që ka shërbyer për suspendimin e katër profesionistëve shëndetësorë për të amnistuar përgjegjësinë politike. Në të njëjtën mënyrë dhe pa asnjë fakt ishin suspenduar drejtuesi i Inspektoratit të Burgjeve dhe pjesëtarë të Shërbimit Korrektues të Kosovës e që kanë kaluar në heshtje. Njerëzit më të merituar për suksesin e SHKK janë margjinalizuar, janë larguar, janë dhunuar psiqikisht dhe institucionalisht duke u zëvendësuar me persona që në të kaluarën e kanë dëmtuar jashtëzakonisht shumë këtë shërbim. Çfarë kuptimi kushte shënimi i Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut kur në Kosovë një numër i qytetarëve shqiptarë mbahen peng nga bandat paramilitare serbe dhe ruse në Veri, të papenguara nga ndërkombëtarët dhe kur liria e lëvizjes dhunohet pikërisht nga ndërkombëtarët përmes mohimit të liberalizimit të vizave.

Në veri të Kosovës nuk ka asnjë shkelje e të drejtave të njeriut nëse qeveria e zbaton ligjin për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa bërë asnjë dallim në baza etnike, politike, racore, fetare, moshore, kulturore e të tjera dhe KMDLNj-së e thotë me përgjegjësi se nuk ka shkelje të kësaj natyre, përkundrazi, sikur edhe qeveritë tjera vazhdon t'ua paguaj rrymën, ujin, mbeturinat dhe shërbimet tjera duke dëmtuar në këtë mënyrë qytetarët e tjerë që në kushte të rënda ekonomike detyrohen, edhe me përmbarues t'i shlyejnë faturat. Asnjë shtet nuk lejon që me shantazh dhe barrikada, e që i shërbejnë Serbisë të fitojnë favore politike. E pse duhet ta lejojë këtë Kosova duke i bërë presion të paparë bashkësia ndërkombëtare.



# Artistët e mëdhenj mbështetin kërkesën që lulëkuqja të bëhet simbol i gjenocidit në Kosovë






EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Kërkesën që Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur" ua ka drejtuar institucioneve të Kosovës, që lulëkuqja të bëhet simbol i gjenocidit në Kosovë, ka hasur në mbështetje edhe tek artistët e mëdhenj si Ilir Shaqiri, Kastriot Tusha, Genc Prelvukaj, Hysni Klinaku etj.

Nëpërmjet llogarisë së tij në "Facebook", këngëtari, kompozitori e shkrimtari Ilir Shaqiri, njëherësh edhe ikonë e këngës shqipe në Kosovë, ka shprehur mbështetjen e tij për këtë propozim. "Së bashku, në mbështetje të iniciativës së qendrës 'Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur', në shërbim të kujtesës sonë kolektive!", ka shkruar Ilir Shaqiri duke shpërndarë lulëkuqen me katër petale në profilin e tij.

Edhe artisti tjetër i madh, tenori Kastriot Tusha, ka shpërndarë kërkesën që lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol unik i gjenocidit në Kosovë.

Në një komunikim me Bardhyl Mahmutin, kryetar i Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur", ka shkruar: "Është gjetje shumë interesante dhe shpresoj të bie në vesh jo të shurdhët. Urime për këtë angazhim që mendoj do të përkrahet!".

Të theksojmë se edhe artistë të tjerë si Genc Prelvulaj e Hysni Klinaku i kanë dhënë mbështetje kërkesës që lulëkuqja të bëhet simbol i përkujtimit të gjenocidit në Kosovë. "Lulëkuqja me katër petale, që sipas ideatorëve simbolizojnë katër format e veprimeve gjenocidale të shtetit serb ndaj shqiptarëve, e që janë vrasjet, dhunimet, spastrimi etnik dhe shkatërrimi i trashëgimisë kulturore e cila shpreh identitetin tonë etnik, është shenja më adekuate për ta kthyer në simbol përkujtimi. Brenda petaleve, në mes me ngjyrë të zezë, shfaqen figura njerëzish, të cilët u vranë, dhunuan apo ende nuk dihet gjë për fatin e tyre. Për t'i shtuar kuptimin, simboli ka dy ngjyrat shpirtërore të shqiptarëve. Prandaj, institucionet e vendit duhet ta mbështetin kërkesën e qendrës 'Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur' që kjo shenjë të njihet, pranohet dhe të vihet në përdorim për të shënuar e përkujtuar gjenocidin serb ndaj shqiptarëve të Kosovës si një prej barbarive më të mëdha njerëzore të shekujve të fundit", ka shkruar Genc Prelvukaj.



Hysni Klinaku, pas shpërndarjes së flajerit me thirrjen për mbështetje të kërkesës që lulëkuqja të bëhet simbol i përkujtimit të gjenocidit në Kosovë, ka ndryshuar edhe fotografinë e profilit duke e vendosur lulëkuqen në vend të fotografisë së tij.

## Domethënia e emblemës së lulëkuqes

Emblema e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur", të katër petalet e lulëkuqes paraqesin katër format e veprimeve të gjenocidit që u zbatuan në Kosovë: vrasjet, dhunimet seksuale, spastrimin etnik dhe shkatërrimin e objekteve që lidhen me përkatësinë etnike dhe identitetin shqiptar. Ndërsa në vend të kokrrave të zeza të lulëkuqes, në logo janë paraqitur figura burrash, grash, djemsh dhe vajzash për t'i përfshirë të gjitha kategoritë e shqiptarëve që ishin shndërruar në objekt shkatërrimi nga politika e gjenocidit të Serbisë.

## Konjufca në Maqedoni, takon Pendarovskin dhe Xhaferin

SHKUP, 12 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjfuca, ka qëndruar të hënën për një vizitë zyrtare në Maqedoninë e Veriut. Konjufca është pritur nga presidenti i këtij shteti, Stevo Pendarovski dhe kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi. "Gjatë takimeve të ngrohta e tejet miqësore shkëmbyem mendime për aktualitetin politik, zhvillimet rajonale dhe mbështetjen e ndërsjellë në rrugën e integrimit evropian të shteteve tona. Në diskutimet përmbajtjesore mbizotëroi fryma e pajtimit të plotë rreth interesave të përbashkëta të bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut", ka deklaruar Konjufca.

Ai ka bërë me dije se në këto takime u vlerësuan të shkëlqyera marrëdhëniet e deritashme dhe u ritheksua gatishmëria për kultivimin e mëtutjeshëm të raporteve mes dy vendeve, përfshirë edhe bashkëpunimin ndër-parlamentar, duke konsideruar se avancimi i marrëdhënieve dypalëshe në të gjitha sferat me interes të përbashkët i kontribuon zhvillimit të ndërsjellë, stabilitetit të rajonit dhe më gjerë.

"Me presidentin Pendarovski dhe kryetarin Xhaferi ndamë pikëpamje të njëjta se i gjithë Ballkani Perëndimor duhet të integrohet sa më parë në BE dhe në NATO, meqë një hap i tillë nuk do të linte hapësira destabilizimi në rajonin tonë", ka thënë Konjufca pas takimit.



# Të vërtetat e mbretit Jim










Me të mbushur 18 vjeç dhe pasi mbaronin fakultetin, të gjithë djemtë kërkonin nga prindërit një makinë të re ose veshje të modës së fundit. Ai jo: ai donte nga babai ynë veprat e plota të Niçes». Siç u ka hije heronjve të përjetshëm dhe perëndive të rëna, Jim Morrison, më shumë se pesëdhjetë vjet pas vdekjes së tij, duket se është përgjithmonë 27 vjeç. Por lideri i The Doors ishte gjithashtu një fëmijë i klasës së mesme amerikane, djali i një admirali, një adoleshent i shqetësuar, sepse ishte gjithmonë në lëvizje prej punës së babait, përpara se të bëhej djaloshi përfundimisht rebel që të gjithë njohim. Portreti i gjallë i mësipërm vjen në fakt nga Anne Morrison Cheuning, motra dhe e vetmja në jetë që kishte ruajtur marrëdhëniet me vëllanë, pasi ai u bë i famshëm: Jimit i pëlqente të thoshte, në intervista të ndryshme, se prindërit kishin vdekur.

## 28 Fletoret

Dhe është vetë Anne, tashmë mësuese 75-vjeçare në pension, e cila së bashku me mikun e përjetshëm të këngëtarit, fotografin Frank Lisciandro, redaktuan serinë monumentale: Të gjitha shkrimet e Jim Morrison, poezitë, ditarët, shënimet dhe tekstet.

Janë 582 faqe të nxjerra nga 28 fletoret dhe materiale të tjera të ndryshme që i përkisnin Jimit, të shkruara, gjatë ekzistencës së tij të shkurtër, kudo që mundi, fletë gazetash, shënime hoteli, shami e peceta. Në synimin e pangopur për të demonstruar gjithmonë një supozim: Mbreti Hardhucë me pantallona lëkure të ngushta, seks-simboli i dëshiruar nga mijëra adoleshentë, në fakt nuk e konsideronte veten këngëtar, një yll rocku, por shkrimtar.

Kënaqësia e tij më e madhe, në katër vitet e trazuara, nga 1967 deri në 1971, që do ta çonin nga lavditë planetare të Light My Fire drejt vdekjes në një vaskë pariziane, ishte në fakt botimi, me emrin e tij të plotë, James Douglas Morrison, i dy libërthave me poezi, midis 100 dhe 500 kopje, "Krijesat e reja" dhe "Një lutje amerikane". "Të gjitha këto shënime i gjetëm me shënimin 'projekte për një libër'. Tani ia plotësuam dëshirën", thotë sërish motra. Dhe, duke bërë një hap prapa në vitet e kolegjit, ajo kujton: "Vëllai im lexonte gjithmonë dhe çdo mundësi ishte e mirë për të blerë një libër ose për të lënë mësimet dhe për t'u futur në një bibliotekë, për t'u zhytur në autorët e tij të preferuar". Dhe është një panteon shumë i saktë, ai i Jimit: Rimbaudi, Bodleri, Molieri, Balzaku dhe Floberi, klasikët grekë, nga Sofokliu te Plutarku por edhe bashkëkohësit amerikanë, mjeshtrit e beat-it Jack Kerouac, Allen Ginsberg, Gregory Corso dhe Laërence Ferlinghetti. Një panteon që më pas do të linte shenjë në tekstet e pavdekshme të The Doors (një emër i krijuar gjithashtu prej tij, nga Aldous Huxley dhe dyert e tij të perceptimit).

"Kur, për shembull, tek kënga "The End", Jim thotë se dëshiron të vrasë të atin dhe të bëjë dashuri me nënën e tij, ai i referohet Edipit Mbret të Sofokliut, sigurisht jo prindërve tanë të vërtetë", thekson sërish Anne. Po, Jim nuk donte të vriste babanë e tij admiral (i cili shfaqet në shumë foto të papublikuara në vëllim, foto nga borgjezia e vogël amerikane, mbrëmje mature, formalizmat me kostum dhe kravatë), por përplasja me të është epike. Përplasje mes brezave të Shteteve të Bashkuara të viteve '60: ushtria drejton manovrat në Tonkin, Vietnam, ndërsa djali këndon një nga himnet më të mira antimilitariste të krijuara ndonjëherë, "Ushtari i Panjohur".

Me Jimin, të cilin kur ishte gjallë madje e bëri lanet, do të pajtohej vetëm pas vdekjes, kur ndër të tjera, pasi heroina mori edhe shoqen e tij, Pamela Courson, do të bëhej për ironi të fatit, së bashku me prindërit e saj, trashëgimtari i vetëm i pasurisë së këngëtarit. "Kishte një moral të tijin, ndoqi rrugën e tij deri në pasoja ekstreme, do të kisha dashur ta njihja më mirë", do të thoshte më vonë admirali plak, duke mos u fshehur lotët në një prej intervistave të fundit para se të vdiste, në vitin 2008 në moshën 90 vjeç.

## Një marsian

Por për atë Jim që ai nuk e njihte, momenti i sfidës më të madhe ndaj establishmentit (dhe për rrjedhojë ndaj babait të tij) ndodh kur, më 1 mars 1969, ul pantallonat para një publiku në Miami, tregon organet e tij gjenitale dhe i fyen ata: "Grusht idiotësh të ndyrë, tufë skllevërsh". Është fillimi i fundit dhe asgjë nuk do të jetë më njësoj për këngëtarin: ai merret nga policia dhe akuzohet për akte të turpshme. Më 10 gusht 1970 hapet procesi, përsëri në Miami: Jim mban shënim gjithçka që ndodh, duke kthyer portrete të gjalla të jurisë, ekzaktësisht në të kundërtën, "Z. A. veteriner, ish trajner i kuajve të garës" ose "Zonja D, shtëpiake, fustan blu i ndezur". Duket si një marsian, Jimi, në ato sallat e gjyqit, duket qartë nga shënimet, të pranishme në vëllim: do të dënohej me gjashtë muaj dhe vetëm një garanci prej 50,000 dollarësh do të shmangte burgun.

Një marsian që bën autostop. Në libër është edhe skenari i albumit ku ai shfaqet si një nomad nëpër rrugët e Los Angeles. Skenari është pak i çuditshëm, vrasje misterioze, vizione ëndërrimtare, dhe fundi në vendin e tij të preferuar, barin "Whiskey a Go Go" në Sunset Strip. "Një lloj ushtrimi për mua, një nxemje për diçka më të madhe", do të thoshte ai vetë në një prej intervistave të fundit. Ajo gjëja më e madhe nuk do të ndodhte, por një prej poezive që la pas, duket se shpreh gjithçka:

"Më vjen keq për netët dhe vitet e hedhura tutje / pas katër vitesh ndihem si një çekan i rraskapitur". Për ta mbyllur në fund: "Gëzimi për t'u shfaqur më ka mbaruar / Gëzimi është kënaqësia për të shkruar". Po, gara ka mbaruar. Jim është tani një shkrimtar i vërtetë. | *Sette – Bota.al*



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Ndalohet pjesëmarrja e tifozëve të organizuar në ndeshjet e basketbollit

Këshilli për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive ka mbajtur mbledhje urgjente pas dhunës së shfaqur në finalen e Superkupës në mes të Prishtinës dhe Trepçës. Ky këshill ka dënuar veprimet e dhunshme derisa mori vendim që të ndalohet pjesëmarrja e tifozëve në mënyrë të organizuar në ndeshjet e basketbollit



"Epoka e re"

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Këshilli për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive ka mbajtur takim pas dhunës që pati të dielën në finalen e Superkupës në mes të Prishtinës dhe Trepçës. Në mbledhjen e jashtëzakonshme, anëtarët e këtij këshilli kanë shprehur indinjatën e thellë dhe i kanë dënuar rëndë incidentet e shkaktuara nga pjesëtarët e grupeve të tifozëve që identifikohen si "Plisat" nga Prishtina, "Torcida" nga Mitrovica, "Arpagjikët" nga Prizreni dhe "Shqiponjat" nga Peja. Këshilli për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive kërkon nga të gjitha organet ligjzbatuese që të ndërmarrin urgjentisht veprime përkatëse ligjore për identifikimin e personave që kanë kryer vepra të kundërligjshme dhe t'i marrin masat përkatëse për dënimin e tyre. Njëkohësisht, Këshilli për Sport e dënon ashpër sulmin e shkaktuar nga huliganët ndaj katër zyrtarëve të Policisë së Kosovë, të cilët pësuan lëndime trupore gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, si edhe ndaj qytetarëve që, po ashtu, u lënduan nga personat e papërgjegjshëm dhe të gjithëve u uron shërim të shpejtë. "Jemi njoftuar se dy prokurorë nga Prokuroria e Prishtinës menjëherë kanë dalë në vendngjarje, të cilët, bashkë me zyrtarët e Policisë së Kosovës, janë duke punuar në vazhdimësi për identifikimin e personave që kanë shkaktuar incidentet e mbrëmshme dhe së shpejti priten veprimet konkrete për vënien e tyre para përgjegjësisë ligjore. Përveç dëmeve të shkaktuara nga veprimet e tilla huliganeske në aspektin e prishjes së imazhit të përgjithshëm të shtetit dhe institucioneve që përkrahin dhe organizojnë ngjarjet sportive, shkaktimit të veprave të tjera kundërvajtëse dhe penale (sharjet në kor, hedhja e mjeteve piroteknike, pjesëmarrja në sulm fizik etj.), janë shkaktuar edhe dëme të konsiderueshme materiale duke dëmtuar pronën publike të palestrës sportive dhe personat keqbërës duhet të mbahen përgjegjës për të gjitha këto shkelje", thuhet në njoftimin e lëshuar nga Këshilli për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive.

Këshilli në fjalë ka hartuar kërkesat që të ndalohet pjesëmarrja në mënyrë të organizuar dhe me çfarëdo shenje dalluese e të gjitha grupeve të tifozëve në ndeshjet e basketbollit, të cilat organizohen nga Federata e Basketbollit e Kosovës, deri në një njoftim tjetër, kurse ka kërkuar nga të gjitha grupet e tifozëve të cilët deri më tani nuk janë regjistruar te Departamenti i Organizatave Joqeveritare (DOJQ) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ta bëjnë këtë gjë në afatin më të shkurtër kohor dhe, pas regjistrimit, ta deponojnë listën me emrat e kryesisë dhe emrat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të OJQ-së te Drejtoria për Sport e komunës përkatëse.

